

**UDHËZIM**  
**Nr. 17, datë 4.9.2012**

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 19, DATË 1.9.2011 “PËR MODALITETET E APLIKIMIT TË PULLAVE TË AKCIZËS DHE PULLAVE FISKALE NË PRODUKTET E DUHANIT, BIRRËS DHE ALKOOLIT”**

Bazuar në nenin 55 paragrafi 1 germa “g” e ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Financave

**UDHËZON:**

Në udhëzimin nr. 19, datë 1.9.2011 “Për modalitetet e aplikimit të pullave të akcizës dhe pullave fiskale në produktet e duhanit, birrës dhe alkoolit”, bëhet ky ndryshim:

1. Pika 10.1 e udhëzimit ndryshohet me këtë përmbajtje:

10.1 16 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi (9 janar 2013), asnjë produkt pa pullën e akcizës apo pullën fiskale sipas këtij udhëzimi, nuk mund të shitet apo të shpërndahet në territorin e Shqipërisë, me përjashtim të produkteve me NK 2208 sipas shtojcës nr. 1: Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë, të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Të gjithë importuesit dhe prodhuesit e produkteve të akcizës, me përjashtim të produkteve me NK 2208 sipas shtojcës nr. 1: Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë, të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të cilët kanë paguar detyrimin e akcizës nëpërmjet pullave të akcizës së prodhuar nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë para datës 9 mars 2012 dhe i kanë gjendje stok në magazinat e tyre të tilla produkte në datën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, duhet që brenda datës 10 shtator 2012 të deklarojnë stokun në organin tatimor ku janë të regjistruar dhe lejohen ta shesin këtë produkt stok deri në datën 9 janar 2013.

Në rast se deri në datën 9 janar 2013, importuesit dhe prodhuesit e produkteve të akcizës, me përjashtim të produkteve me NK 2208, vlerësojnë se nuk mund ta shesin stokun e datës 10 shtator 2012, të deklaruar tek administrata tatimore, deri në datën 9 janar 2013, atëherë gjatë muajit dhjetor 2012 këto subjekte duhet të marrin masa që të pajisen me pullën fiskale të prodhuar nga Koncesionari për stokun e deklaruar tek administrata tatimore të datës 10 shtator 2012, sipas procedurës së porositjes së pullave fiskale të udhëzimit nr. 19, datë 1.9.2011. Autoriteti kontraktues autorizon mbivendosjen e pullave të prodhuara nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë me pullat e reja të prodhuara nga Koncesionari vetëm përkundrejt pagesës së kostos së printimit të pullës së re.

Kërkesës për pulla fiskale të prodhuara nga Koncesionari, subjektet duhet t'i bashkëlidhin detyrimisht kopje të stokut të inventarit të datës 10 shtator 2012, dorëzuar tek administrata tatimore, si dhe kopje të dokumentacionit të porositjes dhe pagesës së akcizës dhe kostove të pullave të akcizës së prodhuar nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë.

Përjashtimisht, në rastin e prodhuesve të produktit birrë, të cilët kanë prodhuar birrë para datës 9 mars 2012 dhe kanë deklaruar gjendje stok tek administrata tatimore në datën 10 shtator 2012, pajisjen me pullë fiskale të prodhuar nga Koncesionari, sipas procedurave të parashikuara në udhëzimin nr. 19, datë 1.9.2011, kundrejt pagesës së akcizës dhe kostove të printimit të pullave fiskale. Kërkesës për pulla fiskale të prodhuara nga Koncesionari, duhet t'i bashkëlidhet detyrimisht dokumentacioni që provon prodhimin e produktit para datës 9 mars 2012.

Në këtë udhëzim nuk përfshihen subjektet e tregtisë me shumicë ose pakicë që mbajnë e tregtojnë produktet e mësipërme të akcizës. Këto subjekte nuk duhet të pranojnë të blejnë produkte akcize me pullën e prodhuar nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë pas datës 9 janar 2013.

Ky udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I FINANCAVE**  
**Ridvan Bode**